

Vendim nr. 19 datë 04.04.2023

(V-19/23)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Sonila Bejtja, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 04.04.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 29 (A) 2022 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **AGRON LAÇAJ**

SUBJEKT I INTERESUAR:

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 30, datë 10.03.2022 dhe nr. s'ka, datë 18.03.2022 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2022-787, datë 05.07.2022 dhe nr. 00-2022-901, datë 14.07.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit Shkodër, me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27-30, 39, 42 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar pranimin pjesërisht të kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në vitin 1999 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka regjistruar procedimin penal nr. 245 në ngarkim të kërkuesit, duke e akuzuar për kryerjen e veprave penale “Vrasja me dashje” dhe “Mbajtja pa leje e armëve luftarake”, të parashikuara nga nenet 76 dhe 278, paragrafi 2, të Kodit Penal (KP).

2. Me vendimin nr. 226, datë 25.07.2000, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit Agron Lan Laçaj për kryerjen e veprës penale “Vrasje me dashje”, parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 20 (njëzet) vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Agron Lan Laçaj për kryerjen e veprës penale “Vrasje me dashje”, parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 20 (njëzet) vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Agron Lan Laçaj për kryerjen e veprës penale “Mbajtja pa leje e armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i KP-së dhe dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim. Në aplikim të nenit 55 të KP-së, përfundimisht dënimin e të pandehurit Agron Lan Laçaj me 25 (njëzet e pesë) vjet burgim.”.*

3. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 159, datë 15.12.2000, ka vendosur: *“Prishjen e vendimin nr. 226, datë 25.07.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.”.*

4. Në rigjykim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 110 (51-2012-1276), datë 28.02.2012, ka vendosur deklarimin të pafajshëm të kërkuesit për veprat penale “Vrasja” në dëm të shtetasve S.R. dhe L.H. dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake”, të parashikuara nga nenet 76 dhe 278/2 të KP-së, si dhe konstatimin e shuarjes së masës së sigurimit personal në burg të caktuar ndaj tij me vendimin nr. 2, datë 02.03.2000 të Gjykatës së Apelit Shkodër. Gjykata ka arsyetuar, ndër të tjera, se dëshmitë e shtetasve L.L. dhe K.L. janë marrë në shkelje të dispozitave ligjore, çka passjell shkelje të procesit të rregullt ligjor, se kërkuesi ka vepruar në kushtet e mbrojtjes së nevojshme dhe se veprimi kryesor e vendimtar për realizimin e vrasjes nuk provohet se është kryer prej tij.

5. Mbi ankimin e prokurorit, me vendimin nr. 199, datë 17.04.2014, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 110 (51-2012-1276), datë 28.02.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke deklaruar kërkuesin fajtor për kryerjen e veprave penale “Vrasja me dashje” në dëm të shtetasve S.R. dhe L.H. dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake”, të parashikuara nga nenet 76 dhe 278/2 të KP-së, dhe në zbatim të nenit 55 të KP-së e ka dënuar atë përfundimisht me 25 vjet burgim.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2016-26, datë 14.01.2016, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit.

7. Në datën 31.05.2017 kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve të gjykatave të zakonshme. Me vendimin nr. 67, datë 10.11.2017, Gjykata ka vendosur shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2016-26, datë 14.01.2016 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë. Gjykata ka vlerësuar se në kushtet kur për çështjen e fajësisë kishte dy vendime diametralisht të kundërta dhe pretendimet e kërkuarit përfshiheshin brenda juridiksionit të Gjykatës së Lartë, kjo e fundit, në respektim të standardit të arsyetimit të vendimit, duhet t’u kishte dhënë përgjigje dhe të shprehej për to, në respektim të rolit të saj kontrollues dhe parimit të subsidiaritetit (*shih vendimin nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese, paragrafët 18-21*).

8. Në rigjykim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1 (8), datë 14.01.2022, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 199, datë 17.04.2014 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

9. Në datën 19.01.2022 kërkuari i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me kërkesë për konstatimin e humbjes së fuqisë së masës së sigurimit personal “Arresti në burg” të caktuar ndaj tij, duke pretenduar se në kushtet kur vendimi i fajësisë nr. 199, datë 17.04.2014 i Gjykatës së Apelit Shkodër është shfuqizuar me vendimin nr. 00-2022-1 (8), datë 14.01.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, prodhon efekte vendimi nr. 110 (51-2012-1276), datë 28.02.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, përmes të cilit ai është deklaruar i pafajshëm dhe është shuar masa e sigurimit personal e vendosur me vendimin nr. 2, datë 02.03.2000 të Gjykatës së Apelit Shkodër.

10. Me vendimin nr. 36 (126), datë 20.01.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka konstatuar moskompetencën e saj për të vendosur për këtë kërkesë, duke ia kaluar atë Gjykatës së Lartë, si gjykata pranë së cilës ndodheshin aktet e dosjes gjyqësore.

11. Me vendimin nr. 00-2022-75, datë 10.02.2022, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur dërgimin e akteve Gjykatës së Apelit Shkodër, si gjykata kompetente për shqyrtimin e masës së sigurimit, konkretisht trupit gjykues që do të shqyrtonte çështjen në themel, pasi në momentin e paraqitjes së kërkesës aktet ndodheshin në atë gjykatë. Kërkesa e kërkuarit për konstatimin e humbjes së fuqisë së masës së sigurimit personal është marrë në shqyrtim nga Gjykata e Apelit Shkodër në datën 10.03.2022, në seancë gjyqësore në prani të avokatit mbrojtës dhe të prokurorit, pasi kërkuari vullnetarisht ka zgjedhur të mos jetë i pranishëm. Në kuadër të kërkesave paraprake, krahas konstatimit të humbjes së fuqisë së masës, për shkak se

në kushtet e prishjes nga Gjykata e Lartë të vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër për fajësinë e kërkuesit prodhon efekte vendimi i pafajësisë, prokuroria ka kërkuar edhe caktimin e masës “Arresti në burg” ndaj tij, duke vlerësuar, ndër të tjera, se: ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova për kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar dhe se ai është autor i kësaj vepre penale; vepra penale “Vrasja me dashje”, e parashikuar nga neni 76 i KP-së, dënohet me burgim nga 10 – 20 vjet; nuk ekzistojnë shkaqe padënueshmërie ose të shuarjes së veprës penale; ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen dhe vërtetësinë e provës; ekziston rreziku i ikjes së të pandehurit, me qëllim shmangien nga përgjegjësia penale; ekziston rreziku që për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit, ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin po procedohet.

12. Me vendimin nr. 30, datë 10.03.2022, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur: “1. Konstatimin e faktit se masa e sigurimit “Arrest në burg” e caktuar ndaj kërkuesit Agron Laçaj me vendimin nr. 2, datë 02.03.2000 të Gjykatës së Apelit Shkodër është shuar me vendimin nr. 110 (51-2012-1276), datë 28.02.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. 2. Caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale për të pandehurin Agron Laçaj. 3. Rrëzimin e kërkesës për lirimin e kërkuesit Agron Laçaj.”.

13. Për rekursin e kërkuesit ndaj vendimit të lartpërmendur të Gjykatës së Apelit Shkodër, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-787, datë 05.07.2022, ka vendosur mospranimin.

14. Gjatë seancës për shqyrtimin e çështjes penale në ngarkim të tij nga Gjykata e Apelit Shkodër, pas kthimit për rigjykim nga Gjykata e Lartë, kërkuesi ka kërkuar shuarjen e masës së sigurisë të vendosur me vendimin nr. 30, datë 10.03.2022 të kësaj gjykate, duke pretenduar humbjen e fuqisë së saj që nga data 13.03.2022, për shkak se vendimi për caktimin e masës nuk i është komunikuar dhe se ai nuk është marrë në pyetje brenda 72 orësh nga marrja e saj. Me vendimin e ndërmjetëm nr. s’ka, datë 18.03.2022, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur rrëzimin e kërkesës.

15. Kërkuesi ka ushtruar rekurs kundër vendimit të lartpërmendur, për të cilin Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-901, datë 14.07.2022, ka vendosur mospranimin.

16. Në datën 07.11.2022 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës, duke kërkuar shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve nr. 30, datë 10.03.2022 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr. 00-2022-787, datë 05.07.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë për caktimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg”.

17. Po kështu, në datën 16.11.2022, ai i është drejtuar sërish Gjykatës, duke kërkuar edhe shfuqizimin e vendimeve nr. s'ka, datë 18.03.2022 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr. 00-2022-901, datë 14.07.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

18. Bazuar në nenin 1 të ligjit nr. 8577/2000, nenin 57 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe nenin 19, pika 2, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës, me vendimin e datës 15.12.2022, Kolegji i Gjykatës ka vendosur bashkimin e çështjeve në një të vetme me nr. 29 (A) të Regjistrit Themeltar.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

19. **Kërkuesi** ka parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, se i janë cenuar:

19.1. *Liria personale*, e garantuar nga nenet 27 e 28 të Kushtetutës dhe neni 5, pikat 1, shkronja “c”, 2 dhe 3, i KEDNJ-së, pasi:

19.1.1. Ndodhet i izoluar për efekt të zbatimit të një mase sigurimi personal të dhënë në kundërshtim me ligjin. Liria e tij personale është kufizuar pa vendim gjykatë, në shkelje të Kushtetutës, KEDNJ-së, si dhe vendimeve unifikuese nr. 4, datë 24.06.2009 dhe nr. 7, datë 14.10.2011 (*vendimi unifikues nr. 7/2011*) të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (KBGJL). Me shfuqizimin nga Gjykata e Lartë të vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër që e ka deklaruar fajtor, prodhon efekte vendimi i pafajësisë i gjykatës së rrethit, i cili është i ekzekutueshëm në zbatim të nenit 462, pika 2, të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe përmes të cilit është liruar nga ambientet e paraburgimit edhe herën e parë. Gjykata e apelit nuk ka çelur hetimin gjyqësor dhe nuk ka marrë ose shqyrtuar ndonjë provë, ndërsa Gjykata e Lartë nuk ka pranuar rekurset, pavarësisht se në to ngriheshin pretendime për shkelje të rënda procedurale dhe zbatim të gabuar të ligjit procedural me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore.

19.1.2. Kërkesa për konstatimin e shuarjes së masës fillestare duhej të ishte bërë nga prokurori gjatë shqyrtimit të çështjes së themelit nga Gjykata e Lartë dhe shuarja e masës duhej të ishte konstatuar nga kjo gjykatë. Në momentin e shfuqizimit nga Gjykata e Lartë të vendimit të fajësisë, bazuar në dispozitat e KPP-së dhe ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, të ndryshuar (*ligji nr. 8331/1998*), prokurori duhej t’i kishte komunikuar urdhërarrestin, ndërsa gjykata duhej ta kishte marrë në

pyetje brenda 72 orësh. Moskryerja e këtyre veprimeve ka bërë që masa e sigurimit të humbasë fuqinë. Për rrjedhojë, prokurori duhej të nxirrte menjëherë urdhrin e ekzekutimit për lirim të tij nga ambientet e IEVP-së.

19.2. *E drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të:*

19.2.1. *Parimit të sigurisë juridike të lidhur me pritshmëritë e ligjshme*, për shkak të caktimit të masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, ndërkohë që është në fuqi vendimi i pafajësisë.

19.2.2. *Së drejtës së aksesit*, pasi Gjykata e Lartë duhej ta kishte kaluar çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore dhe të jepte përgjigje në seancë për pretendimet e ngritura në rekurs.

19.2.3. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi, nga njëra anë, Gjykata e Apelit Shkodër pranon humbjen e fuqisë së masës së vendosur me vendimin nr. 2, datë 02.03.2000 të saj, nga ana tjetër e cakton sërish atë, në interpretim të gabuar të vendimit unifikues nr. 7/2011 të KBGJL-së. Arsyetimi i saj është keqdashës në raport me vendimin unifikues, pasi e mbështet vendimmarrjen mbi baza hipotetike, imagjinatë dhe prezumime të përgjithshme, pa bërë dallim për rastin konkret e pa marrë parasysh vendimin e pafajësisë. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs. Formulimi i vendimmarrjes së saj nuk përbën arsyetim, pasi referimi i dispozitës ligjore nuk zëvendëson mendimin e gjyqtarit me atë të ligjvënësit. Arsyetimi se rekursi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në ligj, nuk përcakton nëse janë analizuar shkaqet e parashtruara në të. Vendimi i saj është i paarsyetuar, alogjik dhe kontradiktor, pasi vendos mospranimin e rekursit, pavarësisht se shkaqet e parashtruara kishin të bënin me shkelje të të drejtave të tij themelore.

19.2.4. *Parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi prokurori nuk kishte kompetencë lëndore për të kërkuar caktimin sërish të masës së sigurimit personal dhe kërkesa e tij nuk duhet të ishte pranuar nga gjykata e apelit. Po kështu, gjykata nuk duhet të kishte shqyrtuar kërkesën e prokurorit gjatë zhvillimit të seancës për shuarjen e masës së vendosur me vendimin nr. 2, datë 02.03.2000 të saj. Kjo shkelje nuk është rregulluar as nga Gjykata e Lartë.

19.2.5. *Parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme*, pasi kërkesat e tij për konstatimin e humbjes së fuqisë së masës së vendosur me vendimin nr. 2,

datë 02.03.2000 të Gjykatës së Apelit Shkodër, si dhe për shuarjen e masës së vendosur me vendimin nr. 30, datë 10.03.2022 të saj janë shqyrtuar nga i njëjti trup gjykues i Gjykatës së Apelit Shkodër.

19.2.6. *Barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi ai nuk është informuar për kërkesën e prokurorisë për caktimin e masës së sigurimit dhe arsyet e saj, duke mos iu dhënë mundësia të paraqesë pretendime e të dëgjohet. Ai është njoftuar nga gjykata e apelit vetëm për zhvillimin në datën 10.03.2022 të seancës gjyqësore për shqyrtimin e kërkesës së tij për konstatimin e humbjes së fuqisë së masës dhe nuk është njoftuar për kërkesën e paraqitur po atë ditë nga prokuroria për caktimin e saj. Kërkuesi nuk ka marrë pjesë në seancën e shqyrtimit të masës dhe as nuk është dëgjuar në lidhje me pretendimet e tij, në shkelje të nenit 259, pikat 1 dhe 2, të KPP-së. Pavarësisht se në seancë ka qenë i pranishëm mbrojtësi, ky i fundit kishte dijeni vetëm për marrjen në shqyrtim të kërkesës së tij për shuarjen e masës dhe jo të kërkesës së prokurorisë për caktimin e saj.

19.2.7. *Parimit ne bis in idem*, për shkak të rivendosjes së masës së sigurimit personal në kundërshtim me vendimin unifikues nr. 7/2011 të KBGJL-së, pasi nuk ka ndryshuar asnjë rrethanë nga dhënia e vendimit të pafajësisë.

20. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar:

20.1. Pretendimi i kërkuesit për cenimin e *së drejtës për liri personale* është i pabazuar, pasi nuk arrin nivelin e një kërkimi kushtetues, ndaj duhet të rrëzohet. Për ligjshmërinë e caktimit rishtazi të masës së sigurimit, Gjykata e Lartë ka disponuar me vendim për mospranimin e rekursit, në zbatim të juridiksionit lëndor të saj për interpretimin e ligjit penal dhe procedural.

20.2. Pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* është i bazuar dhe duhet pranuar. Sipas praktikës gjyqësore të deritanishme, masa e sigurimit nuk mund të caktohet për një fakt penal për të cilin individ i është shpallur i pafajshëm me vendim gjyqësor, edhe pse ky vendim nuk është i formës së prerë. Mbajtja e një qëndrimi të ndryshëm nga Gjykata e Apelit Shkodër dhe Gjykata e Lartë, pa ndjekur kjo e fundit procedurat për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, cenon në thelb këtë parim.

20.3. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *së drejtës së aksesit*, ndërkohë që nuk rezulton që kjo e drejtë të jetë cenuar nga Gjykata e Apelit Shkodër, ajo është shkelur nga Gjykata e Lartë, në drejtim të aksesit substancial të kërkuesit në

këtë gjykatë, për shkak se pretendimet e ngritura në rekurs duhej të ishin shqyrtuar në seancë gjyqësore, ku të vlerësohej nevoja për gjykim njësores ose ndryshues të praktikës gjyqësore.

- 20.4. Ndonëse në vendimet e kundërshtuara kolegjet penale të Gjykatës së Lartë kanë arsyetuar në lidhje me kompetencën e gjykatës së apelit për shqyrtimin e kërkesës së prokurorit me objekt caktimin e masës së sigurimit personal, ato nuk përmbushin *standardin e arsyetimit të vendimit*, pasi nuk kanë arsyetuar në lidhje me thelbin e lirisë personale, duke mos i dhënë përgjigje pretendimit të kërkuarit nëse ndaj tij mund të caktohej një masë sigurimi personal në kushtet kur ishte në fuqi një vendim pafajësie.
- 20.5. Pretendimet e kërkuarit për cenimin e *parimit të gjykatës së caktuar me ligj*, për shkak të mungesës së kompetencës lëndore të Gjykatës së Apelit Shkodër në marrjen në shqyrtim të kërkesës së prokurorit për caktimin e masës, si dhe *parimit të gjyqimit nga një gjykatë e paanshme* janë të pabazuara. Kompetenca e kësaj gjykate është njohur me vendimin unifikues nr. 7/2011 të KBGJL-së, sipas të cilit, gjatë fazës së gjyqimit penal kompetente për shqyrtimin e masës është gjykata/trupi gjyqësor që shqyrton çështjen e themelit.
- 20.6. Gjykatat kanë respektuar *parimin e kontradiktoritetit*. Sipas nenit 244 të KPP-së, caktimi i masës së sigurimit bëhet nga gjykata në dhomën e këshillimit, ndërsa marrja në pyetje e personit të arrestuar, sipas nenit 248 të këtij kodi, bëhet në prani të palëve. Në seancën e datës 10.03.2022, për shqyrtimin e kërkesës për shuarjen e masës, ka qenë i pranishëm avokati i kërkuarit, i cili ka marrë dijeni gjatë seancës për kërkesën e prokurorit për caktimin e masës dhe ka pasur mundësinë e ushtrimit të së drejtës për ta kundërshtuar atë, duke iu garantuar e drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur. Pretendimi për shkelje të *së drejtës për t'u dëgjuar*, për shkak të mosmarrjes në pyetje brenda afatit 72 orësh nga caktimi i masës së sigurimit, është i pabazuar. Masa është caktuar në seancë gjyqësore në prani të palëve, ndërsa neni 248 i KPP-së gjen zbatim në rastin e parashikuar në nenin 244 të këtij kodi, kur masa është caktuar në dhomën e këshillimit, sipas ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 35/2017 dhe, sipas ligjit të kohës, në seancë gjyqësore me pjesëmarrjen e vetme të prokurorit të çështjes.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuësit

21. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

22. Si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

23. Detyrimi për *shterimin e mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, është trajtuar nga Gjykata si në rastet e vendimeve përfundimtare, që kanë përmbyllur procesin gjyqësor (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*), ashtu edhe të atyre të ndërmjetme, karakteri i të cilave është konsideruar përfundimtar për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 28, datë 23.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Lidhur me këto të fundit, Gjykata ka përfshirë në juridiksionin kushtetues edhe vendime gjyqësore për caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”, duke arsyetuar se karakteri i këtij vendimi, që lidhet me heqjen e lirisë së individit, si përjashtim, e bën atë një vendim përfundimtar në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 40, datë 18.07.2012; nr. 28, datë 23.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesi ka kundërshtuar procedurat gjyqësore për caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arresti në burg”, të cilat kanë përfunduar me vendimin nr. 00-2022-787, datë 05.07.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesi i ka shteruar mjetet juridike

efektive në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese që pretendon se i janë shkelur në këto procedura gjyqësore.

25. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000, ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Sipas informacionit të marrë nga Gjykata e Lartë, vendimi i saj nr. 00-2022-787, datë 05.07.2022, i kundërshtuar nga kërkuesi, është bërë i disponueshëm për palët në datën 20.07.2022, ndërsa ankimi kushtetues individual fillestar është paraqitur në Gjykatë në datën 07.11.2022, pra brenda afatit ligjor 4-mujor. Po kështu, vendimi nr. 00-2022-901, datë 14.07.2022 i Gjykatës së Lartë është bërë i disponueshëm për palët në datën 29.07.2022, ndërsa kërkesa e dytë është depozituar në Gjykatë në datën 16.11.2022. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione temporis* në kërkesën e tij, sipas objektit.

26. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar se gjykatat i kanë cenuar lirinë personale, si dhe të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të sigurisë juridike, së drejtës së aksesit, parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme dhe e caktuar me ligj, barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, parimit *ne bis in idem*, si dhe standardit të arsytimit të vendimit. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë thelbin e pretendimeve të kërkuesit, do t’i analizojë ato në këndvështrim të lirisë personale, si dhe të procesit të rregullt ligjor, në aspektin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e lirisë personale

27. Kërkuesi ka pretenduar se liria e tij personale është kufizuar në kundërshtim me Kushtetutën, KEDNJ-në dhe legjislacionin në fuqi, pasi në kushtet kur vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër, përmes të cilit ishte deklaruar fajtor, është shfuqizuar nga Gjykata e Lartë, prodhon efekte vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, përmes të cilit ishte deklaruar i pafajshëm. Nga ana tjetër, nga data 14.01.2022, kur Gjykata e Lartë ka vendosur shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër që e ka deklaruar fajtor, e deri në datën 10.03.2022, kur mbi bazën e kërkesës së tij është konstatuar shuarja e masës së sigurimit personal nga Gjykata e Apelit Shkodër, liria e tij personale është kufizuar pa pasur një vendim gjyqësor. Gjykata e apelit nuk ka marrë parasysh vendimin e pafajësisë, nuk ka çelur hetimin gjyqësor për caktimin e masës, nuk ka marrë ose shqyrtuar ndonjë provë, duke vendosur caktimin e masës pa pasur prova rënduese e pa bërë rivlerësim të provave të marra nga gjykata e rrethit. Në rekurs janë ngritur pretendime për shkelje të rënda procedurale dhe zbatim të gabuar të ligjit procedural me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës

gjyqësore. Në zbatim të nenit 446 të KPP-së, kërkesa për konstatimin e shuarjes së masës duhej të ishte bërë nga prokurori gjatë shqyrtimit të çështjes së themelit në seancën gjyqësore në Gjykatën e Lartë dhe shuarja e masës duhej të ishte konstatuar nga kjo gjykatë.

28. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka parashtruar se ndërkohë që pretendimet e kërkuarit për cenimin e së drejtës për liri personale, të parimit të kontradiktoritetit, si dhe të së drejtës për t'u dëgjuar duhen rrëzuar, pretendimet për cenimin e parimit të sigurisë juridike, të aksesit substancial dhe të standardit të arsytimit të vendimit janë të bazuara, pasi, sipas praktikës gjyqësore të deritanishme, masa e sigurimit nuk mund të caktohet për një fakt penal për të cilin individit është shpallur i pafajshëm me vendim gjyqësor, edhe pse ky vendim nuk është i formës së prerë. Mbajtja e një qëndrimi të ndryshëm nga Gjykata e Apelit Shkodër dhe Gjykata e Lartë, pa ndjekur kjo e fundit procedurat për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, cenon në thelb këtë parim. Po kështu, kolegjet penale të Gjykatës së Lartë nuk i kanë dhënë përgjigje pretendimit të kërkuarit nëse ndaj tij mund të caktohej një masë sigurimi personal në kushtet kur ishte në fuqi një vendim pafajësie.

29. Neni 27, pika 1, i Kushtetutës parashikon se askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj, të cilat parashikohen në mënyrë të detajuar në KPP. Neni 27, pika 2, i Kushtetutës parashikon rastet e kufizimit të lirisë personale, ndërsa shkronja "c" e kësaj dispozite kushtetuese parashikon si të tilla ekzistencën e dyshimeve të arsyeshme për kryerjen nga individit të një veprë penale, parandalimin e kryerjes prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj. Sipas nenit 28, pika 2, të Kushtetutës, personi, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, paragrafi 2, nënparagrafi "c", duhet të dërgohet brenda 48 orëve përpara gjyqtarit, i cili vendos paraburgimin ose lirinë e tij jo më vonë se 48 orë nga çasti i marrjes së dokumenteve për shqyrtim.

30. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se kushtet, kriteret dhe procedurat për caktimin, zbatimin, rivlerësimin, zëvendësimin dhe kontrollin gjyqësor për masat e sigurimit, veçanërisht atyre të arrestit, janë drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, konkretisht me lirinë e personit dhe se këto procedura duhet të kenë karakter gjyqësor dhe të sigurojnë garancitë e duhura sipas llojit të privimit të lirisë (*shih vendimet nr. 40, datë 18.07.2012; nr. 28, datë 23.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Duke mbajtur në konsideratë se liria personale, e garantuar nga neni 27 i Kushtetutës, mbrohet edhe nga neni 5 i KEDNJ-së, Gjykata vlerëson t'i referohet jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas së cilës "*dyshimet e arsyeshme*" për kryerjen e veprës penale, që justifikojnë kufizimin e lirisë personale të individit, nënkuptojnë ekzistencën e fakteve ose informacioneve që arrijnë të bindin edhe një

vëzhgues të jashtëm se personi i dyshuar mund të ketë kryer veprën penale. Këto fakte nuk është e nevojshme të jenë në të njëjtin nivel si ato për të cilat nevojitet ngritja e akuzës ose justifikimi i dënimit penal, të cilat i përkasin një shkalle të mëvonshme të procesit të hetimit penal (*shih vendimin Selahattin Demirtas kundër Turqisë (nr. 2) [DHM], datë 22.12.2020, §§ 314-315 të GJEDNJ-së*).

32. Gjykata vë në dukje se koncepti i “dyshimit të arsyeshëm” për kufizimin e lirisë personale është trajtuar edhe nga praktika unifikuese e KBGJL-së, konkretisht vendimet nr. 7/2011 dhe nr. 3, datë 27.09.2002. Kështu, dyshimi konsiderohet i arsyeshëm për kufizimin e lirisë personale nëse bazohet në fakte dhe informacione, të cilat krijojnë bindjen se ekziston një lidhje objektive midis personit të dyshuar dhe veprës penale për të cilën akuzohet. Ai nënkupton bindjen që krijohet në bazë të provave të marra në përputhje me kërkesat e ligjit, të cilat, në unitetin e tyre, tregojnë se vepra penale ka ndodhur dhe se ajo është kryer nga ai që akuzohet.

33. Gjykata vëren se në zbatim të delegimit të nenit 27 të Kushtetutës, rastet dhe procedurat e kufizimit të lirisë personale për shkak të veprave penale janë parashikuar në KPP. Një prej tyre është ai i caktimit të masës së sigurimit, që kërkon ekzistencën e disa kushteve të përgjithshme dhe të veçanta (*neni 228*), si dhe përmbushjen e disa kriterëve të veçanta (*neni 230*). Në përputhje me nenin 27, pika 2, shkronja “c”, të Kushtetutës, kusht i domosdoshëm (*sine qua non*) për caktimin e masës së sigurimit është ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova se individ i ka kryer një vepër penale (*neni 228, pika 1*).

34. Për sa më lart dhe referuar thelbit të argumenteve të parashtruara në ankimin kushtetues, Gjykata vlerëson t’i analizojë pretendimet e kërkuar për cenimin e lirisë personale në raport me standardin kushtetues të “*dyshimit të arsyeshëm*” dhe rregullat procedurale të KPP-së për caktimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg”.

35. Në rastin konkret, ashtu siç u parashtrua edhe më lart (*shih paragrafët 1-15 të vendimit*), Gjykata konstaton se gjatë shqyrtimit të kërkesës së kërkuar për konstatimin e humbjes së fuqisë së masës së caktuar me vendimin nr. 2, datë 02.03.2000 të Gjykatës së Apelit Shkodër, ndërsa ka pranuar humbjen e fuqisë së saj, prokuroria pranë kësaj gjykate ka kërkuar caktimin e masës së sigurisë. Me vendimin nr. 30, datë 10.03.2022, Gjykata e Apelit Shkodër, konkretisht trupi gjykues i caktuar për shqyrtimin e çështjes penale në ngarkim të kërkuar, ka konstatuar faktin e shuarjes së masës fillestare dhe ka pranuar kërkesën e prokurorit për caktimin e saj, duke e gjetur atë të bazuar në prova dhe ligj. Për sa i takon kësaj vendimmarrjeje, Gjykata konstaton se gjykata e apelit ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur faktin penal e cilësimin e tij sipas dispozitave të KP-së. Po kështu, bazuar në vendimin unifikues nr. 7/2011,

sipas të cilit masa e sigurimit mund të caktohet si gjatë fazës së hetimit paraprak, ashtu edhe gjatë gjykimit, gjykata ka arsyetuar se bazuar në faktet dhe provat e gjykimit provohet ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm se kërkuesi i ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet dhe për të cilat është deklaruar fajtor me vendimin nr. 199, datë 17.04.2014 të saj, për rrjedhojë ekzistojnë kushtet e parashikuara në nenin 228 të KPP-së për caktimin e masës (*shih vendimin nr. 30, datë 10.03.2022 të Gjykatës së Apelit Shkodër, faqja 8*). Edhe Gjykata e Lartë, pas shqyrtimit të rekursit të kërkuesit, me vendimin nr. 00-2022-787, datë 05.07.2022, duke vendosur mospranimin e tij, e ka gjetur të drejtë vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër për caktimin e masës së sigurimit, në vlerësim të kushteve dhe kriterëve për caktimin e saj. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se vendimi i pafajësisë ndaj kërkuesit nuk ka marrë formë të prerë, për shkak të kthimit të saj për rishqyrtim, për rrjedhojë vendimmarrja e gjykatës së apelit nuk i ka cenuar të drejtat procedurale dhe kushtetuese (*shih vendimin nr. 00-2022-787, datë 05.07.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, faqja 5*).

36. Në vijim, në seancën gjyqësore të datës 18.03.2022 për rigjykimin nga Gjykata e Apelit Shkodër të çështjes penale në ngarkim të tij, kërkuesi ka kërkuar shuarjen e masës së sigurimit të vendosur me vendimin nr. 30, datë 10.03.2022 të kësaj gjykate, duke pretenduar shkeljen e së drejtës për proces të rregullt ligjor. Me vendimin nr. s'ka, datë 18.03.2022, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke e gjetur atë të pambështetur në ligj. Për sa u takon pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi, gjykata e apelit ka arsyetuar se detyrimi për njoftimin e masës së sigurimit lind në rastet kur ajo caktohet me kërkesë të prokurorit, sipas nenit 246 të KPP-së, kërkesë e cila shqyrtohet në dhomën e këshillimit pa dijeninë e personit ndaj të cilit caktohet. Po sipas gjykatës, në rastin e kërkuesit masa e sigurimit është caktuar në mungesë të vullnetshme të tij dhe në prani të mbrojtësit të zgjedhur, ndërsa në lidhje me pretendimet për shkeljen e nenit 261/2 të KPP-së, ajo ka vlerësuar se rasti i parashikuar nga pika 2 e këtij neni zbatohet kur paraburgimi është urdhëruar gjatë hetimeve paraprake, ndërsa në rastin në gjykim, masa e sigurimit është caktuar gjatë gjykimit të çështjes (*shih vendimin nr. s'ka, datë 18.03.2022 të Gjykatës së Apelit Shkodër, faqet 2 dhe 3*). Me vendimin nr. 00-2022-901, datë 14.07.2022, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, duke e vlerësuar të drejtë vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër. Gjykata vëren se në vendimin për çështjen, Kolegji Penal është shprehur në të njëjtën linjë me gjykatën e apelit, duke arsyetuar se kërkuesi është njoftuar rregullisht për ditën dhe orën e zhvillimit të seancës gjyqësore dhe është përfaqësuar në gjykim nga mbrojtësi i zgjedhur prej tij, për rrjedhojë nuk konstatohet cenim i të drejtave të tij procedurale ose kushtetuese (*shih*

vendimin nr. 00-2022-901, datë 14.07.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, faqja 4, paragrafët 19-20).

37. Në këndvështrim të sa më lart, Gjykata vëren se kufizimi i lirisë personale të kërkuesit është vendosur me vendim gjyqësor, bazuar në dyshime të arsyeshme për kryerjen prej tij të veprave penale për të cilat akuzohet dhe sipas procedurave të parashikuara nga ligji. Në këtë drejtim, gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë kanë evidentuar në vendimet e tyre ekzistencën e fakteve që mbështesin dyshimin e arsyeshëm se kërkuesi mund të ketë kryer veprën penale. Ashtu siç evidenton edhe Gjykata e Lartë, ndonëse vendimi i fajësisë është prishur dhe çështja është kthyer për rigjykim në shkallën e dytë për të vlerësuar bazueshmërinë e vendimit të pafajësisë, për sa kohë vendimi i shkallës së parë nuk ka marrë formë të prerë, kërkuesi ruan të njëjtin status procedural. Gjykata vëren se gjykata e apelit ka analizuar faktet dhe provat në ngarkim të kërkuesit në raport me kushtet dhe kriteret për kufizimin e lirisë personale, duke arsyetuar vendimin e saj si për sa u takon pretendimeve të tij për cenimin e lirisë personale, ashtu edhe për sa u përket konkluzioneve të arritura prej saj për ekzistencën e “dyshimeve të arsyeshme” për kufizimin e kësaj të drejte. Po kështu, pretendimet e ngritura nga kërkuesi në rekurs janë analizuar dhe vlerësuar nga Gjykata e Lartë, e cila ka arsyetuar gjetjet e saj në drejtim të të drejtave procedurale dhe kushtetuese të tij. Në këto kushte, Gjykata çmon se në rastin konkret kufizimi i lirisë personale të kërkuesit nuk rezulton të jetë në kundërshtim me nenin 27, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, nenin 5, pika 1, shkronja “c”, të KEDNJ-së dhe dispozitat ligjore përkatëse të KPP-së që përcaktojnë procedurat e kufizimit të kësaj lirie.

38. Nga ana tjetër, Gjykata vëren, gjithashtu, se pretendimeve të kërkuesit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, për shkak të mosnjoftimit të vendimit nr. 30, datë 10.03.2022 të Gjykatës së Apelit Shkodër për caktimin e masës, si dhe mosmarrjes në pyetje brenda 72 orësh, gjykata e apelit u ka dhënë përgjigje të arsyetuar, duke argumentuar për rastet kur legjislacioni në fuqi përcakton detyrimin për njoftimin e masës, si dhe në lidhje me zbatimin e garancive të procesit të rregullt ligjor në çështjen e tij. Ajo i ka konsideruar të përmbushura garancitë e procesit të rregullt ligjor, në kushtet kur avokati mbrojtës, i zgjedhur nga kërkuesi me prokurë të posaçme, ka qenë i pranishëm në seancë dhe ka marrë dijeni për kërkesën e prokurorisë për caktimin e masës, duke iu dhënë mundësi të paraqesë pretendime në këtë drejtim e të dëgjohet. Po kështu, pretendimet e ngritura nga kërkuesi në rekurs në lidhje me këtë gjykim janë marrë në shqyrtim nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit, e cila ka vlerësuar se rekursi nuk plotësonte kushtet e parashikuara në nenin 437 të KPP-së për shqyrtimin e tij në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Kjo gjykatë ka arsyetuar edhe në

lidhje me thelbin e pretendimeve të kërkuarit, duke argumentuar konkluzionin e arritur prej saj se në rastin e tij janë garantuar të drejtat procedurale dhe kushtetuese. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se kufizimi i lirisë personale të kërkuarit nuk rezulton të jetë bërë në kundërshtim me nenin 28 të Kushtetutës, dispozitat e KEDNJ-në, jurisprudencën kushtetuese ose dispozitat ligjore në fuqi dhe se gjykatat e zakonshme kanë mbajtur parasysh garancitë e ofruara nga kuadri kushtetues dhe ligjor në këtë drejtim.

39. Në përfundim të analizës së mësipërme, Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit dhe zbatimi i tij në çështjen konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Gjykata ndërhyr vetëm kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete, kanë cenuar të drejtat kushtetuese të palëve (*shih vendimin nr. 34, datë 17.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në çështjen në shqyrtim, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë edhe rolin subsidiar të saj në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, vlerëson se interpretimi dhe zbatimi i ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm janë bërë duke marrë parasysh garancitë që ofron parimi i procesit të rregullt ligjor dhe se në rastin konkret nuk shfaqen probleme në aspektin kushtetues, të tilla që do të kërkonin ndërhyrjen e saj, për rrjedhojë nuk rezulton që liria personale e kërkuarit të jetë cenuar në kundërshtim me dispozitat kushtetuese.

40. Për sa më lart, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e lirisë personale është i pabazuar.

B.2. Për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme

41. Kërkuari ka pretenduar se kërkesat e tij për konstatimin e humbjes së fuqisë së masës së vendosur me vendimin nr. 2, datë 02.03.2000 të Gjykatës së Apelit Shkodër, si dhe për shuarjen e masës së vendosur me vendimin nr. 30, datë 10.03.2022 të saj janë shqyrtuar nga i njëjti trup gjykues i Gjykatës së Apelit Shkodër.

42. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka pretenduar se pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme dhe e caktuar me ligj duhet rrëzuar, pasi, sipas vendimit unifikues nr. 7/2011 të KBGJL-së, gjatë fazës së gjykimit penal, kompetente për shqyrtimin e masës është gjykata/trupi gjykues që shqyrton çështjen e themelit.

43. Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga gjyqtarët për

çështjen e shtruar përpara tyre. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 10, datë 12.04.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

44. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet *subjektiv*, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin *objektiv*, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimi nga vetë ajo të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Ndër të tjera, gjykata merr parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohen nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Në shtetin e së drejtës kërkesa për një gjykim të paanshëm merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë, që në shoqëritë demokratike duhet ta krijojnë në çdo rast jo vetëm palët në gjykim, por dhe çdo qytetar i thjeshtë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 15, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Sipas Gjykatës, ligji procedural penal përcakton rregulla të tilla që bëjnë dallim thelbësor mes fazës së hetimit paraprak dhe fazës së gjykimit. Në fazën e gjykimit, gjykata duhet të marrë vendime pa qenë e ndikuar nga vendimmarrja e mëparshme, qoftë edhe kur ato bazohen në dyshime të arsyeshme. Gjykata ka çmuar se paragjykimi eventual për paanësinë e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën kur gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 10, datë 12.04.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Në rastin konkret, në ankimin kushtetues individual kërkuar ka pretenduar cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, për shkak se si në rastin e kërkesës së parë për konstatimin e humbjes së fuqisë së masës, ashtu edhe në rastin e kërkesës së dytë, për shuarjen e saj, çështja është shqyrtuar nga i njëjti trup gjykues i Gjykatës së Apelit Shkodër.

47. Për sa i takon këtij pretendimi, Gjykata vëren se rregullat e KPP-së për gjykatën kompetente që shqyrton kërkesat për masat e sigurimit (nenet 13, 15, 17, 18, 21, 244, pika 1, 246 dhe 260, 261) janë unifikuar nga KBGJL-ja me vendimin nr. 7/2011, sipas së cilit masa e sigurimit mund të caktohet rishtazi edhe në fazën e gjykimit, madje nga e njëjta gjykatë që shqyrton themelin e akuzës, nëse verifikohen kushtet dhe kriteret ligjore për caktimin e masës së sigurimit. I vetmi organ që procedon me çështjen penale të dërguar për gjykim, pra edhe për caktimin e masës së sigurimit, revokimin e zëvendësimit të saj, është gjykata e caktuar për

gjykimin e veprës penale në fazën e gjykimit e deri në dhënien e vendimit përfundimtar. Në këtë kuptim, kur kërkesa është paraqitur për gjykim, kompetenca për të vendosur caktimin, zëvendësimin a revokimin e masave të sigurimit i përket vetëm gjykatës së caktuar për shqyrtimin e çështjes. Me depozitimin e kërkesës për gjykim, kompetenca e gjyqtarit të fazës së hetimeve paraprake për të trajtuar kërkesa lidhur me masat e sigurimit i ka kaluar gjykatës së caktuar për gjykimin e çështjes penale.

48. Sipas nenit 438, pika 8, të KPP-së, vendimet e KBGJL-së janë të detyrueshme për gjykatat në gjykimin e çështjeve të ngjashme, ndërsa vlera që kanë vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë në rendin juridik e detyrimi ligjor që kanë gjykatat më të ulëta që të marrin parasysh dhe zbatojnë në çështje analoge zgjidhjet e dhëna në këto vendime, është pranuar edhe nga jurisprudenca kushtetuese (*shih vendimin nr. 10, datë 12.04.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

49. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata eidenton se çështja penale në ngarkim të kërkuessit i është dërguar për rishqyrtim Gjykatës së Apelit Shkodër me vendimin nr. 00-2022-1 (8), datë 14.01.2022 të Gjykatës së Lartë. Ndërkohë, me vendimin nr. 00-2022-75, datë 10.02.2022, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka përcaktuar si kompetente Gjykatën e Apelit Shkodër, konkretisht trupin gjykues të saj që do të shqyrtonte çështjen në themel, për shqyrtimin e kërkesës së kërkuessit për konstatimin e humbjes së fuqisë së masës fillestare, pasi në momentin e paraqitjes së kërkesës aktet ndodheshin pranë saj (*shih vendimin nr. 00-2022-787, datë 05.07.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, faqja 3, paragrafi 15*). Në këto kushte, si kërkesa e kërkuessit për konstatimin e humbjes së fuqisë së masës së sigurimit të caktuar me vendimin nr. 2, datë 02.03.2000 të Gjykatës së Apelit Shkodër, ashtu edhe kërkesa e tij për shuarjen e masës së vendosur me vendimin nr. 30, datë 10.03.2022 të kësaj gjykate janë marrë në shqyrtim nga i njëjti trup gjykues, i cili po shqyrton çështjen penale të themelit (në zbatim të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga vendimi unifikues nr. 7/2011 i KBGJL-së). Gjykata vëren se këto vendime janë marrë brenda të njëjtit gjykim/procedim, ndaj në rastin e kërkuessit nuk ka papajtueshmëri të trupit gjykues.

50. Në kuptim të sa më lart, Gjykata vëren se në zbatim të dispozitave ligjore të KPP-së, sipas interpretimit të vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë, shqyrtimi nga i njëjti trup gjykues i Gjykatës së Apelit Shkodër i kërkesave të kërkuessit për konstatimin e humbjes së fuqisë dhe shuarjen e masës së sigurimit personal të caktuar ndaj tij, nuk rezulton të ketë cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme, në aspekt të testit objektiv. Gjykimi i çështjes së themelit vijon ende në Gjykatën e Apelit Shkodër, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara sipas gjetjeve në vendimin nr. 00-2022-1 (8), datë 14.01.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se në këndvështrimin kushtetues, kërkesat e kërkuessit

për konstatimin e humbjes së fuqisë së masës së sigurimit, si dhe për shuarjen e saj janë shqyrtuar nga një gjykatë e paanshme, e caktuar me ligj dhe se në rastin e tij nuk rezulton të jenë shkelur garancitë e ofruara nga Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi në këtë drejtim.

51. Për sa më sipër, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme është i pabazuar.

52. Në përfundim, Gjykata vlerëson se ankimi kushtetues i kërkuarit, sipas arsytimit të mësipërm, është i pabazuar, ndaj duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 04.04.2023

Shpallur më 04.05 .2023

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkues Agron Laçaj, me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 30, datë 10.03.2022 dhe nr. s'ka, datë 18.03.2022 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2022-787, datë 05.07.2022 dhe nr. 00-2022-901, datë 14.07.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ne, gjyqtarët në pakicë, ndajmë qëndrim të ndryshëm nga shumica, pasi vlerësojmë se pretendimet e kërkuesit për cenimin e lirisë personale janë të bazuara, për rrjedhojë duhej të ishte vendosur pranimi i kërkesës.

2. Pa dashur të përsërisim faktet që kanë rezultuar gjatë këtij gjykimi, të cilat janë pasqyruar në vendim, theksojmë se ato që marrin rëndësi të veçantë në funksion të argumentimit të qëndrimit tonë në këtë çështje janë si vijon.

3. Kërkuesi është marrë si i pandehur dhe është gjykuar për kryerjen e veprave penale “Vrasja me dashje” dhe “Mbajtja pa leje e armëve luftarake”, të parashikuara nga nenet 76 dhe 278, pika 2, të KP-së, për vrasjen e shtetasve L.H. dhe S.R., ngjarje e ndodhur më 07.09.1999 në rrugën Koplik-Bajzë, akuzë për të cilën ai është deklaruar fajtor dhe është dënuar me 25 vjet burgim me vendimin nr. 226, datë 25.07.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Pas prishjes së këtij vendimi nga Gjykata e Apelit Shkodër, në rigjykim, i cili është zhvilluar me ritin e zakonshëm, me vendimin nr. 110 (51-2012-1276), datë 28.02.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka vendosur: *“Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Agron Lan Laçaj për veprën penale “Vrasje” së shtetasit L.H., parashikuar nga neni 76 i KP-së. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Agron Lan Laçaj për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i KP-së, sipas nenit 388/d të KPP-së.”*. Po ashtu, me këtë vendim, në zbatim të nenit 389 të KPP-së dhe në përputhje me nenin 261, pika 1, shkronja “a”, të këtij kodi, gjykata ka vendosur edhe: *“Konstatimin e shuarjes së masës së sigurimit personal në burg të caktuar ndaj të pandehurit Agron Lan Laçaj, të caktuar me vendimin nr. 2, datë 02.03.2000 të Gjykatës së Apelit Shkodër.”*. Ky urdhërim i gjykatës është ekzekutuar dhe kërkuesi është liruar nga paraburgimi.

4. Mbi ankimin e prokurorit ky vendim është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Shkodër, e cila, me vendimin nr. 199, datë 17.04.2014, ka vendosur të deklarojë fajtor kërkuesin për kryerjen e veprave penale për të cilat akuzohej, duke e dënuar përfundimisht me 25 vjet burgim. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka paraqitur rekurs kërkuesi, për të cilin Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2016-26, datë 14.01.2016, ka vendosur mospranimin e tij.

5. Pas shfuqizimit të vendimit të Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese, në rishqyrtimin e kësaj çështjeje Kolegji Penal, me vendimin nr. 08, datë 14.01.2022, ka prishur vendimin nr. 199, datë 17.04.2014 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe e ka kthyer çështjen për rishqyrtim në po atë gjykatë, pasi ka konstatuar se vendimi i saj është i pavlefshëm për shkak të mungesës së arsytimit, duke vërejtur se ajo ka konkluduar në deklarin fajtor të të gjykuarit në lidhje me akuzën e ngritur pa bërë një hetim të plotë e të gjithanshëm të fakteve dhe rrethanave të parashtruara nga palët në gjykim, si dhe se ajo ka arritur në një përfundim të ndryshëm nga gjykata e shkallës së parë, vetëm duke vlerësuar ndryshe faktet dhe provat, ndërsa nuk rezulton që kjo vendimmarrje të jetë e arsyetuar. Duke qenë se me prishjen e vendimit të gjykatës së apelit rikthehej fuqia ekzekutive e vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka vendosur deklarin të pafajshëm të kërkuesit, në datën 19.01.2022 ai ka kërkuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër konstatimin e humbjes së fuqisë së masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, të caktuar ndaj tij gjatë hetimeve paraprake dhe urdhërimit të lirimit të menjëhershëm nga paraburgimi. Pas deklarin të moskompetencës nga kjo gjykatë dhe, më pas, edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, kërkesa i ka kaluar për shqyrtim Gjykatës së Apelit Shkodër, si gjykata kompetente ku ndodheshin aktet e çështjes.

6. Në seancën gjyqësore të zhvilluar në gjykatën e apelit, prokurori ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg” ndaj kërkuesit Agron Laçaj. Me vendimin nr. 30, datë 10.03.2022, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur: *“Konstatimin e faktit se masa e sigurimit “Arresti në burg” e caktuar ndaj kërkuesit Agron Laçaj, me vendimin nr. 2, datë 02.03.2000 të Gjykatës së Apelit Shkodër, është shuar me vendimin nr. 110 (51-2012-1276), datë 28.02.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.”*. Po ashtu, me këtë vendim, gjykata ka vendosur edhe: *“Caktimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, të parashikuar nga neni 238 i KPP-së për të pandehurin Agron Laçaj. Rrëzimin e kërkesës për lirimin e kërkuesit Agron Laçaj”*, pasi ka vlerësuar të mundur ligjërisht caktimin e masës së sigurimit ndaj kërkuesit dhe, më tej, se masa e sigurimit e kërkuar nga prokurori i apelit është një masë e nevojshme dhe e përshtatshme.

7. Me vendimin nr. 00-2022-787, datë 05.07.2022, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsytimin se pretendimet e ngritura në të nuk u referohen shkaqeve të parashikuara nga 432 i KPP-së, si dhe ka vlerësuar se është kompetencë e organit të akuzës të kërkojë nga gjykata caktimin e masës së sigurimit për nevoja të hetimit. Sipas Kolegjit Penal, çështja penale është rikthyer për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Shkodër dhe kjo gjykatë ka të drejtë të caktojë masë siguri personal ndaj kërkuesit.

kur vlerëson se plotësohen kushtet dhe kriteret për caktimin e saj. Duke qenë se vendimi i pafajësisë nuk ka marrë formë të prerë, është konsideruar se kërkuesi ka rimarrë pozitën procedurale të të pandehurit.

8. Në datën 17.03.2022 kërkuesi ka paraqitur përpara Gjykatës së Apelit Shkodër kërkesë për shuarjen e masës së sigurimit “Arresti në burg”, të caktuar prej saj me vendimin nr. 30, datë 10.03.2022, me pretendimin se e ka humbur fuqinë nga data 13.03.2022, pasi ky vendim nuk i është komunikuar dhe ai nuk është marrë në pyetje brenda 72 orësh nga marrja e kësaj mase, sikurse kërkohej nga neni 248 i KPP-së. Kjo kërkesë është rrëzuar nga gjykata e apelit me vendimin e datës 18.03.2022, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i vënë në lëvizje nga kërkuesi, me vendimin nr. 00-2022-901, datë 14.07.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se pretendimet e ngritura në të nuk u referohen shkaqeve të parashikuara nga neni 432 i KPP-së, duke gjetur të drejtë përfundimin e gjykatës së apelit se neni 261, pika 2, i KPP-së nuk gjen zbatim në rastin kur masa e sigurimit caktohet gjatë fazës së gjykimit të çështjes.

9. Me kërkesat e datave 07.11.2022 dhe 17.11.2022, të cilat janë bashkuar në një të vetme, kërkuesi Agron Laçaj i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e vendimeve nr. 30, datë 10.03.2022 të Gjykatës së Apelit Shkodër (*vendimi për ricaktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”*), nr. 00-2022-787, datë 05.07.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, nr. s’ka, datë 18.03.2022 të Gjykatës së Apelit Shkodër (*vendimi për rrëzimin e kërkesës për shuarjen e masës së sigurimit “Arresti në burg”*) dhe nr. 00-2022-901, datë 14.07.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit Shkodër.

10. Kërkuesi në ankimin kushtetues individual ka pretenduar cenimin e lirisë personale për shkak se ka vijuar të jetë në kushtet e kufizimit të lirisë, në kundërshtim me nenin 27, pika 1, të Kushtetutës edhe pse vendimi i deklarimit fajtor dhe i dënimit i Gjykatës së Apelit Shkodër është shfuqizuar nga Gjykata e Lartë, çka bënte që të hynin në fuqi efektet juridike të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, përmes të cilit ai ishte deklaruar i pafajshëm dhe ishte liruar nga paraburgimi për shkak të shuarjes së masës së sigurimit “Arresti në burg” të caktuar gjatë hetimeve paraprake. Nga ana tjetër, prej datës 14.01.2022, kur është dhënë vendimi i Gjykatës së Lartë, e deri në datën 10.03.2022, kur është shqyrtuar nga gjykata e apelit kërkesa e tij për lirimin nga paraburgimi, liria e tij personale është kufizuar pa një vendim gjykate. Ai ka pretenduar se Gjykata e Apelit Shkodër, kur ka ricaktuar ndaj tij masën e sigurimit “Arresti në burg”, nuk ka marrë parasysh vendimin e pafajësisë të gjykatës së shkallës së parë, nuk ka çelur hetimin gjyqësor për
Vendim i Gjykatës Kushtetuese
Kërkues: Agron Laçaj

caktimin e masës, nuk ka marrë dhe shqyrtuar ndonjë provë, duke vendosur masën e sigurimit pa pasur prova rënduese e pa bërë rivlerësim të provave të marra gjatë gjykimit në shkallë të parë. Ai ka pretenduar se në momentin e shfuqizimit nga Gjykata e Lartë të vendimit të fajësisë, bazuar në dispozitat e KPP-së dhe ligjin nr. 8331/1998, prokurori duhej t'i kishte komunikuar urdhërarrestin, ndërsa gjykata duhej ta kishte marrë në pyetje brenda 72 orësh. Mosndërmarrja e këtyre veprimeve ka bërë që masa e sigurimit të humbasë fuqinë, ndaj prokurori duhej të nxirrte menjëherë urdhrin e ekzekutimit për lirim nga paraburgimi. Sipas kërkuarit, edhe pse këto shkaqe janë ngritur në rekurs, ato nuk janë marrë parasysh nga Gjykata e Lartë.

11. Neni 27, pika 1, i Kushtetutës parashikon se askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj, ndërsa pika 2 e këtij neni ka përcaktuar në mënyrë shteruese rastet përjashtimore kur lejohet kufizimi i lirisë, mes të tjerash: a) kur është dënues me burgim nga gjykata kompetente; c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një veprë penale ose për të parandaluar kryerjen e veprës penale ose largimin pas kryerjes së saj. Po kështu, e drejta e lirisë dhe sigurisë personale gjen mbrojtje nga neni 5 i KEDNJ-së, në pikën 1 të të cilit parashikohet se askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj: a) kur burgoset ligjërisht pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente; c) kur arrestohet ose ndalohej ligjërisht për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent pas dyshimit të arsyeshëm se ka kryer një veprë penale ose kur çmohet në mënyrë të arsyeshme e nevojshme për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj etj.

12. Këto dispozita përcaktojnë shkaqe të ndryshme, të cilat lejojnë kufizimin e lirisë dhe që gjejnë më tej rregullim në dispozitat procedurale penale. Në kuptim të sa më sipër, dënimi me burgim dhe dyshimi i arsyeshëm për kryerjen e një veprë penale janë jo vetëm shkaqe të ndryshme, por përkrijnë me faza të ndryshme të procesit penal në të cilat gjejnë zbatim ato. Ndërsa dyshimi i arsyeshëm sipas shkronjës "c" i referohet caktimit të masave të sigurimit gjatë fazës së hetimeve paraprake dhe deri në dhënien e një vendimi përfundimtar nga gjykata për fajësinë ose jo të të pandehurit, shkronja "a" kërkon një vendim fajësie, pra jo më ekzistencën e dyshimeve për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri.

13. Sipas GJEDNJ-së, për qëllime të nenit 5, pika 1, shkronja "a", të KEDNJ-së, fjala "dënim" nënkupton konstatimin e fajësisë, pas përcaktimit në përputhje me ligjin se është kryer një veprë penale, si dhe dhënien e dënimit ose të një mase tjetër që përfshin heqjen e lirisë. Për më tepër, fjala "pas" në nënparagrafin "a" të nenit 5, pika 1, nuk nënkupton thjesht se burgimi duhet të ndjekë "dënimin" nga pikëpamja e kohës: përveç kësaj "burgimi" duhet të jetë

rezultat, “të ndjekë dhe të varet” ose të jetë rrjedhojë e “dënimit”. Me pak fjalë, mes të dyve duhet të ekzistojë një lidhje e mjaftueshme shkakësore (*shih Del Río Prada kundër Spanjës, nr. 42750/0, § 124, datë 21 tetor 2013*).

14. Në këtë kuptim, ne vlerësojmë se, ndërsa interpretimi i zgjeruar lejohet vetëm në aspektin pozitiv, pra kur shkon në favor të mbrojtjes së të drejtave themelore të individit, në rastin e rrethanave që lejojnë kufizimin e lirisë, ashtu siç thekson edhe GJEDNJ-ja, atyre duhet t’u jepet një interpretim i ngushtë/kufizuar, duke pasur parasysh faktin se përbëjnë përjashtime nga një prej garancive më themelore, asaj të lirisë individuale (*shih Belozorov kundër Rusisë dhe Ukrainës, nr. 43611/02, § 111, datë 15 tetor 2015*).

15. Deri në dënimin e tij me vendim përfundimtar të gjykatës, i pandehuri prezumohet i pafajshëm dhe në lidhje me caktimin e masave të sigurimit GJEDNJ-ja ka theksuar se vazhdimi i masës së sigurimit mund të justifikohet në një rast të caktuar vetëm nëse ka tregues specifikë të një kërkesë të vërtetë të interesit publik, e cila, pavarësisht prezumimit të pafajësisë, mbart më shumë peshë se sa rregulli i respektimit të lirisë individuale, i parashikuar në nenin 5 të Konventës. Në ushtrimin e funksionit të saj GJEDNJ-ja duhet të sigurojë që argumentet e gjykatave kombëtare pro dhe kundër lirimit nuk duhet të jenë “të përgjithshme dhe abstrakte”, por të përmbajnë referenca për fakte specifike dhe rrethanat personale që justifikojnë masën e sigurimit (*shih Hysa kundër Shqipërisë, §§ 66, 68, datë 21 shkurt 2023*).

16. Në analizë të rrethanave të çështjes konkrete, kufizimi i lirisë personale të kërkuarit me vendimin e gjykatës së apelit të datës 10.03.2022 është bërë bazuar në ekzistencën e “dyshimeve të arsyeshme”, të përcaktuara si kriter në nenin 27, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës dhe nenin 5, pika 1, shkronja “c”, të KEDNJ-së, i cili ka të bëjë me rastet kur çështja e fajësisë nuk është vendosur ende nga gjykata, ndërkohë që në rastin konkret, vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër, që e ka deklaruar fajtor, është shfuqizuar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, çka ka rikthyer fuqinë ekzekutive të vendimit nr. 110 (51-2012-1276), datë 28.02.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, përmes të cilit kërkuari është deklaruar i pafajshëm. Përveç këtij fakti, rezulton se në vendimin e pafajësisë, në respektim të kërkesave të ligjit procedural penal, gjykata ka konstatuar shuarjen *ipso lege* të masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, e caktuar ndaj tij gjatë fazës së hetimeve paraprake, ndërkohë që ekstradimi i kërkuarit dhe burgosja e tij janë bërë në zbatim të vendimit të dënimit me burgim të dhënë nga gjykata e apelit. Edhe Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 30, datë 10.03.2022, ka konstatuar faktin se masa e sigurimit “Arresti në burg”, e caktuar gjatë hetimeve paraprake me vendimin e saj nr. 2, datë 02.03.2000, është shuar me vendimin e pafajësisë së kërkuarit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë.

17. Në vlerësimin tonë në çështjen konkrete janë dy momente të ndryshme që kërkonin trajtim dhe përgjigje nga Gjykata Kushtetuese. I pari ka të bëjë me shuarjen *ipso lege* të masës së sigurimit personal, për shkak se pas shfuqizimit të vendimit të gjykatës së apelit që e kishte dënuar kërkuesin, vendimi i pafajësisë i gjykatës së shkallës së parë kishte rimarrë fuqitë ekzekutive, kurse momenti tjetër ka të bëjë me atë periudhë kohore nga vendimi i Gjykatës së Lartë, që ka prishur vendimin e dënimit të gjykatës së apelit, deri në ricaktimin ndaj e masës së sigurimit “Arresti në burg” gjatë rigjyqimit të çështjes në gjykatën e apelit.

18. Shumica e ka arsyetuar vendimin e saj bazuar në kriteret dhe kushtet për caktimin e masave të sigurimit, duke vlerësuar se referuar thelbit të argumenteve të parashtruara në ankimin kushtetues, pretendimet e kërkuesit për cenimin e lirisë personale do të analizohen në raport me standardin kushtetues të “*dyshimit të arsyeshëm*” dhe rregullat procedurale të KPP-së për caktimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg” (shih paragrafin 34 të vendimit). Sipas saj, “*kufizimi i lirisë personale të kërkuesit është vendosur me vendim gjyqësor, bazuar në dyshime të arsyeshme për kryerjen prej tij të veprave penale për të cilat akuzohet dhe sipas procedurave të parashikuara nga ligji. Në këtë drejtim, gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë kanë evidentuar në vendimet e tyre ekzistencën e fakteve që mbështesin dyshimin e arsyeshëm se kërkuesi mund të ketë kryer veprën penale. Ashtu siç evidenton edhe Gjykata e Lartë, ndonëse vendimi i fajësisë është prishur dhe çështja është kthyer për rigjykim në shkallën e dytë për të vlerësuar bazueshmërinë e vendimit të pafajësisë, për sa kohë vendimi i shkallës së parë nuk ka marrë formë të prerë, kërkuesi ruan të njëjtin status procedural. Gjykata vëren se gjykata e apelit ka analizuar faktet dhe provat në ngarkim të kërkuesit në raport me kushtet dhe kriteret për kufizimin e lirisë personale, duke arsyetuar vendimin e saj si për sa u takon pretendimeve të tij për cenimin e lirisë personale, ashtu edhe për sa u përket konkluzioneve të arritura prej saj për ekzistencën e “*dyshimeve të arsyeshme*” për kufizimin e kësaj të drejte. Po kështu, pretendimet e ngritura nga kërkuesi në rekurs janë analizuar dhe vlerësuar nga Gjykata e Lartë, e cila ka arsyetuar gjetjet e saj në drejtim të të drejtave procedurale dhe kushtetuese të tij. Në këto kushte, Gjykata çmon se në rastin konkret kufizimi i lirisë personale të kërkuesit nuk rezulton të jetë në kundërshtim me nenin 27, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, nenin 5, pika 1, shkronja “c”, të KEDNJ-së dhe dispozitat ligjore përkatëse të KPP-së që përcaktojnë procedurat e kufizimit të kësaj lirie.*” (shih paragrafin 37 të vendimit). Në përfundim, shumica ka vlerësuar se në çështjen në shqyrtim, duke mbajtur në konsideratë edhe rolin subsidiar të kësaj Gjykate në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut “*interpretimi dhe zbatimi i ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është bërë duke marrë parasysh garancitë që ofron parimi i procesit të rregullt ligjor dhe se*

në rastin konkret nuk shfaqen probleme në aspektin kushtetues, të tilla që do të kërkonin ndërhyrjen e saj, për rrjedhojë nuk rezulton që liria personale e kërkuesit të jetë cenuar në kundërshtim me dispozitat kushtetuese” (shih paragrafin 39 të vendimit).

19. Duke iu referuar arsyetimit të shumicës në lidhje me pretendimin e kërkuesit për cenimin e lirisë personale, ai është bazuar në trajtimin e elementeve me natyrë ligjore, por pa e çuar çështjen në nivel kushtetues, edhe pse ajo mbart specifika dhe problematika të dukshme në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e dispozitave procedurale penale, të cilat sjellin efekt të drejtpërdrejtë në të drejtat dhe liritë themelore të individit, veçanërisht duke qenë se ka të bëjë me kufizimin e lirisë personale. Pa pasur nevojë për të vlerësuar nëse në këtë rast ishim para “dyshimit të arsyeshëm” për kufizimin e lirisë personale, shumica duhej të analizonte nëse mund të ricaktohej një masë e tillë e kufizimit të lirisë pas shuarjes *ipso lege* të masës së dhënë më parë për kërkuesin në kushtet e një vendimi pafajësie, trajtim që mungon në këtë rast, duke lënë pa përgjigje dhe analizë aspektet kryesore me natyrë kushtetuese të çështjes konkrete. Në vlerësimin tonë ky qëndrim mund të përbëjë për organet gjyqësore një precedent që mund të çojë në kufizimin jokushtetues të të drejtave të individit.

20. Qëndrimi i shumicës, që ka legjitimuar vendimmarrjen e gjykatave të zakonshme, i ka dhënë vlerë “dyshimit të arsyeshëm” përmbi një vendimi pafajësie, që jepet në përfundim të gjyqimit nga gjykata, mbi analizën dhe çmuarjen në tërësi dhe harmoni të provave të marra, të verifikuara dhe të debatuar rregullisht nga palët, vendim ky që juridikisht nënkupton mungesën e bazueshmërisë faktike të dyshimit për kryerjen e veprës penale dhe fajësinë e të pandehurit, gjithmonë duke respektuar parimin se dyshimi shkon në favor të tij. Sipas nenit 462 të KPP-së, vendimi penal i gjykatës vihet në ekzekutim menjëherë pasi të ketë marrë formë të prerë, kurse vendimi i pafajësisë vihet në ekzekutim menjëherë pas shpalljes, rregullim ligjor ky që tregon për fuqinë ekzekutive të vendimit të pafajësisë, duke mbartur në vetvete dhe duke reflektuar parimin kushtetues të prezumimit të pafajësisë, përveçse mungesën e përligjjes kushtetuese të vijimit të kufizimit të lirisë të një personi të deklaruar të pafajshëm nga gjykata. Qenia i ankimueshëm nga prokurori i vendimit të pafajësisë dhe vijimi i qenies i akuzuar për kryerjen e një veprë penale nuk përbëjnë arsye ligjore, aq më pak kushtetuese dhe konventore, për vazhdimin e kufizimit të lirisë së një personi të deklaruar të pafajshëm nga gjykata. Arsyetimi i shumicës ka shkuar drejt pohimit se individi mund t’i nënshtrohet kufizimit të lirisë për sa kohë pafajësia e tij nuk është vërtetuar me vendim gjyqësor të formës së prerë/të përvokueshëm/*res judicata*, çka nuk ka sens logjik dhe juridik, pasi është fajësia ajo që duhet të vërtetohet, ndërsa pafajësia përbën prezumim kushtetues sipas nenit 30 të Kushtetutës. Kurse neni 446 i KPP-së përcakton se kur në bazë të vendimit të Gjykatës së Lartë duhet të pushojë

vazhdimi i një burgimi sekretaria ia komunikon menjëherë dispozitivin e vendimit prokurorit pranë gjykatës përkatëse, ndërkohë që ky i fundit ka detyrimin ligjor të marrë masa për ekzekutimin menjëherë të tij dhe ndërprerjen e burgimit, për sa kohë parimi kushtetues i mëshiruar në nenin 27, pika 1, të Kushtetutës ndalon heqjen e lirisë së individit, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj, i cili, nga ana tjetër, parasheh burgosjen e individit vetëm me vendim gjykatë.

21. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, bazuar në nenet 15 dhe 42 të Kushtetutës, kanë detyrimin kushtetues të respektojnë dhe të kontribuojnë për realizimin e të drejtave kushtetuese individuale, çka nënkupton se vendimi për dhënien e një masë të tillë, që kufizon lirinë e individit, duhet të jepet në përputhje me standardet e procesit të rregullt ligjor dhe gjykimi nuk duhet të jetë arbitrar. Në rastin konkret, qëndrimi i gjykatave të zakonshme është në kufijtë e një interpretimi arbitrar të ligjit procedural, siç është argumentuar më sipër, me pasojë cenimin e lirive themelore, përveçse, në aspektin e parimit të sigurisë juridike, ka sjellë edhe cenimin e pritshmërive të ligjshme të kërkuesit, në kuptim të nenit 462 të KPP-së, për sa i përket zbatimit të vendimit gjyqësor të pafajësisë që kishte shuar masën e sigurimit ndaj tij dhe që nuk lejonte, për rrjedhojë, ricaktimin e një mase kufizuese të lirisë nën të njëjtin kontekst ligjor dhe faktik.

22. Kërkuesi ka pretenduar edhe se gjykatat kanë vepruar në kundërshtim me vendimin unifikues nr. 7/2011, i cili është referuar nga gjykatat e zakonshme (gjykata e apelit) për të mbështetur qëndrimin e tyre. Sipas Kolegjeve të Bashkuara, ligjvënësi nuk ka vendosur ndonjë kufizim të së drejtës së palëve për të paraqitur kërkesa lidhur me masat e sigurimit, përfshirë atë për caktimin e saj për herë të parë në gjykim, as edhe për gjykatën që procedon (në fazën e hetimit paraprak ose në atë të gjykimit) lidhur me atë kërkesë. Pra, masa e sigurimit mund të caktohet në çdo fazë të procedimit penal, nëse janë nevojat e sigurimit, nëse nga gjykimi del se kanë lindur, ndryshuar apo mungojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara nga ligji (nenet 228 e vijues të KPP-së). Nuk përjashtohet mundësia që, sipas rrethanave konkrete të ecurisë së një procedimi penal, gjykata të caktojë masë sigurimi ndaj personit në hetim apo të pandehurit, edhe pse masa e mëparshme e dhënë ndaj tij ishte shuar ose revokuar më parë nga gjykata. Ndonëse për vetë natyrën dhe mënyrën e zhvillimit të një procedimi penal, masat e sigurimit normalisht e zakonisht caktohen në fazën e hetimit paraprak, nuk ka asnjë logjikë juridike ose pengesë ligjore që këto masa të mos caktohen *për herë të parë* edhe në fazën e gjykimit. Qëllimi dhe efektet e parashikuara nga ligji procedural penal për masën e sigurimit, koncepti juridik i “rrezikut” dhe parimi i “përshtatshmërisë” për caktimin dhe zbatimin e saj, qëndrojnë dhe i

shërbejnë njësoj si fazës së hetimit paraprak, ashtu edhe asaj të gjykimit (*shih vendimin unifikues nr. 7, datë 14.10.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*).

23. Duke iu referuar rrethanave të atij rasti, rezulton se pas shuarjes *ipso lege* të masës së sigurimit personal për të pandehurin, për shkak të pushimit të akuzave nga prokurori, ky vendim është shfuqizuar nga prokurori më i lartë sipas kompetencës së dhënë nga ligji procedural penal i kohës dhe pas përfundimit të hetimeve paraprake çështja është dërguar për gjykim nga Prokuroria pranë Gjykatës për Krimet e Rënda. Është gjatë këtij gjykimi që Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka pranuar kërkesën e prokurorit për caktimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg”. Për rrjedhojë, është kjo situata faktike dhe ligjore ajo mbi të cilën Kolegjet e Bashkuara kanë unifikuar praktikën gjyqësore në lidhje me fazën gjatë së cilës mund të kërkohej caktimi i masës së sigurimit personal, ndërkohë që për të pandehurin në atë rast nuk kishte një masë sigurimi, ndërsa çështja kundër tij ishte në gjykim dhe nuk kishte asnjë vendim përfundimtar për të. Duke qenë kështu, asnjë nga këto përfundime unifikuese nuk gjejnë zbatim në rastin konkret dhe atyre nuk mund t’u jepet një kuptim i ndryshëm nga ai që ka synuar ajo gjykatë.

24. Në vendimin e saj shumica, në lidhje me vendimmarrjen e gjykatave të zakonshme është shprehur se “Gjykata e Apelit Shkodër ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur faktin penal e cilësimin e tij sipas dispozitave të KP-së. Po kështu, bazuar në vendimin unifikues nr. 7/2011, sipas të cilit masa e sigurimit mund të caktohet si gjatë fazës së hetimit paraprak, ashtu edhe gjatë gjykimit, gjykata ka arsyetuar se bazuar në faktet dhe provat e gjykimit provohet ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm se kërkuesi i ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet dhe për të cilat është deklaruar fajtor me vendimin nr. 199, datë 17.04.2014 të saj, për rrjedhojë ekzistojnë kushtet e parashikuara në nenin 228 të KPP-së për caktimin e masës.” (*shih paragrafin 35 të vendimit*).

25. Duke pasur parasysh sa kemi evidentuar më sipër në lidhje me dallimet mes rastit për të cilin është unifikuar praktika gjyqësore dhe atij në shqyrtim, shumica duhej të ishte ndalur në analizën e këtij pretendimi, i cili ka natyrë kushtetuese, për sa kohë që në thelb është pretenduar pikërisht se mënyra e gabuar e leximit dhe zbatimit të këtij vendimi unifikues ka sjellë cenimin e lirive kushtetuese të kërkuesit. Ajo duhej të kishte konstatuar paqartësitë që kanë gjykatat e zakonshme në kuptimin e atij vendimi, duke theksuar rolin e Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, i cili shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta (*shih vendimet nr. 24, datë 25.04.2016; nr. 4, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*) për të vlerësuar vendimet e gjykatave të

zakonshme edhe në drejtim të uniformitetit të interpretimit e zbatimit të së drejtës (*shih vendimin nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Gjatë veprimtarisë gjyqësore gjyqtari i zakonshëm duhet të lexojë edhe përmbajtjen e normës kushtetuese në të njëjtën mënyrë siç vepron me normat e tjera parësore ose dytësore, duke pasur detyrimin të zbatojë dhe interpretojë këto të fundit në frymën e Kushtetutës. Kjo bën që roli i gjykatës së ligjit të zgjerohet dhe transformohet, edhe pse në thelb ajo ruan funksionin e saj tradicional që lidhet me kuptimin dhe zbatimin e ligjit, duke synuar individualizimin dhe interpretimin e drejtë të “normave të së drejtës”. Kjo e bën Gjykatën e Lartë të zhvendoset nga teksti i normës ligjore drejt të drejtave themelore, duke arritur që nëpërmjet funksionit të saj të bashkojë sigurinë e së drejtës me mbrojtjen e të drejtave të individit. Në situatën që çështja ka të bëjë me zbatimin e dispozitave procedurale që rregullojnë institute të ndryshme të së drejtës penale dhe kuptimin e gabuar që i është dhënë qëndrimit të Kolegjeve të Bashkuara të asaj gjykate, Gjykata e Lartë kishte detyrimin jo vetëm të bënte një interpretim nën frymën e atij vendimi unifikuës, në drejtim të uniformitetit të së drejtës, por nëse ishte e nevojshme, të mbante një qëndrim njësesues.

27. Ky është edhe qëndrimi i mbajtur nga subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, sipas të cilit, sipas praktikës gjyqësore të deritanishme, masa e sigurimit nuk mund të caktohet për një fakt penal për të cilin individi është shpallur i pafajshëm me vendim gjyqësor, edhe pse ky vendim nuk është i formës së prerë. Mbajtja e një qëndrimi të ndryshëm nga Gjykata e Apelit Shkodër dhe Gjykata e Lartë, pa ndjekur kjo e fundit procedurat për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, cenon në thelb këtë parim. Po sipas këtij subjekti, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit të kërkuësit nëse ndaj tij mund të caktohej një masë sigurimi personal në kushtet kur ishte në fuqi një vendim pafajësie.

28. Po ashtu, vlerësojmë se në lidhje me aspektin tjetër të kësaj çështjeje, që ka të bëjë me periudhën nga marrja e vendimit të Gjykatës së Lartë që ka prishur vendimin e dënimit të gjykatës së apelit (14.01.2022) dhe deri në marrjen e vendimit për ricaktimin e masës së sigurimit nga gjykata e apelit (10.03.2022), duhej të ishte konstatuar, më së paku, cenimi i lirisë personale të kërkuësit, për sa kohë ky kufizim nuk është justifikuar për ndonjë nga rastet e parashikuara nga neni 27, pika 2, i Kushtetutës.

29. Për të gjitha argumentet e mësipërme, vlerësojmë se kërkesa duhej të ishte pranuar, duke u shfuqizuar vendimet gjyqësore objekt kërkesë që kanë ricaktuar masën e sigurimit personal “Arresti në burg” ndaj kërkuësit, në kushtet kur ndaj tij kishte një vendim

përfundimtar të ekzekutueshëm që e kishte deklaruar të pafajshëm, duke shuar edhe masën e sigurimit të dhënë ndaj tij gjatë hetimeve paraprake.

Anëtarë: Sonila Bejtja, Ilir Toska